



KOR 2021



TITUJT

Editorial: Ohri faqja 1

Aktivitetet tjera të OKB-së faqet 2, 3 & 4

Në fokus faqja 4

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Komiteti i Trashëgimisë Botërore të UNESCO -s nuk e vendosi Ohrin në listën e vendeve të rrezikuara të trashëgimisë botërore në sesionin e 44-të të zhvilluar në korrik 2021, gjë që është një vendim i rëndësishëm që mbart tre mesazhe kryesore:

Së pari, ky vendim nuk e zvogëlon urgjencën për të vepruar, por përkundrazi sinjalizon se koha është duke mbaruar.

Për dekada me radhë, Ohri është pllakosur me ndërtime të papërshtatshme dhe shpesh të paligjishme, menaxhim të dobët të peshkimit dhe mungesë të mbrojtjes së jetës nënujore. Nevoja për ruajtjen e pasurive të tija natyrore dhe kulturore është përbushur me apati. Çështjet e mëdha me të cilat përballet Ohri sot kërkojnë një qasje tërësore, me qëllim të korrigjimit të dëmit të grumbulluar prej vitesh dhe rëndësinë më të madhe që duhet t'i kushtohet planifikimit dhe menaxhimit të ardhshëm të lokalitetit. TANI është koha për të vepruar!

Së dyti, dhënia dy vjet tjera në dispozicion për t'i rritur ndjeshëm përpjekjet drejt masave korrigjuese dhe përmirësimit të menaxhimit të lokalitetit në vete paraqet një mundësi të madhe. Të gjitha përpjekjet duhet të dyfishohen në mënyrë që sa më shpejt të jetë e mundur të rikthehen vlerat e lokalitetit. Kjo do të kërkojë veprim të koordinuar dhe bashkëpunim të ngushtë nga të gjithë aktorët, ku do të kenë rol kryesor pushtetet qendrore dhe vendore, organizatat e shoqërisë civile (OSHC), sektori privat, qytetarët e vendbanimeve përreth, turistët dhe bashkësia ndërkombëtare. Unë i përshëndes përpjekjet e fundit të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe komunave të Ohrit dhe Strugës dhe i përgëzoj përpjekjet e përkushtuara të shoqërisë civile. Familja e OKB-së në Maqedoninë e Veriut është e gatshme të ofrojë mbështetje, që Ohri të qëndrojë jashtë Listës së Trashëgimisë Botërore të Rrezikuara!

Së fundi, fati i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Ohrit e demonstroi rëndësinë e veprimit të përbashkët ose mungesën e tij. Ne duhet të veprimi së bashku sepse Ohri është një e mirë e përbashkët, duke filluar nga njerëzit që jetojnë në brigjet e tij, komunat dhe institucionet shtetërore që e menaxhojnë pjesën dërrmuese të

pasurive natyrore dhe kulturore, pra të gjithë ne qytetarët e Maqedonisë së Veriut dhe qytetarët anekënd globit. Ohri është një thesar për të gjithë botën dhe është detyra jonë e përbashkët ta mbrojmë dhe ruajmë atë, si për brezat tanë, po ashtu edhe për brezat e ardhshëm.



Përkeqësimi i Ohrit gjatë dekadave të fundit paraqet një kujtesë të fortë të ndikimit të sjelljes njerëzore në trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Ne mezi presim që trashëgimia jonë e përbashkët të vihet në listën e rrezikuara për t'i ndryshuar qëndrimet dhe praktikat tona. Për të qenë të qartë, kjo nuk do të thotë që ne duhet të ndalojmë të gjithë zhvillimin, por përkundrazi nënkupton që ne duhet të sigurojmë zhvillim dhe veprim të qëndrueshëm. Në fakt ky është thelbi i Agjendës 2030.

Paraprakisht ne duhet të marrim hapa të guximshëm dhe transformues që do të çojnë drejt përmirësimeve në të tre dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm: ekonomik, social dhe mjedisor. Krijimi i një qasjeje tërësore është çelësi për ta siguruar zhvillimin e qëndrueshëm që duam ta shohim në Ohër dhe kudo tjetër. Ne duhet të veprimi tani për ta mbrojtur Ohrin dhe të gjitha pasuritë tjera natyrore të Maqedonisë së Veriut.

Rossana Duxhak
Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut

DATAT KYÇE

KORRIK

- 1 Mali Sharr i shpallur Park Nacional nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, me mbështetjen e UNEP-it.
- 1-3 Trajnim për buxhetimin me përgjegjësi gjinore për përfaqësuesit e Entit Shtetëror Revizionit, organizuar nga UN Women.
- 7-8 seminare të organizuara nga UN Women për 21 njësi të vetëqeverisjes lokale si pjesë e mbështetjes për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.
- 8 Nisja e Raportit Botëror të Drogës të UNODC 2021, që siguron një analizë të thelluar të tregjeve globale të drogës dhe jep një pamje gjithëpërfshirëse të efekteve të matshme dhe ndikimit të mundshëm të krizës COVID-19 në problemin botëror të drogës.
- 9 Përfundimi i trajnimit 10-ditor për mësuesit e shkollave fillore dhe edukatorët e kopshëve mbi integrimin e shkencave të mjedisit jetësor dhe Klimatit në programin mësimor, të organizuar nga UNICEF-i si pjesë e programit mbi edukimin mjedisor.
- 12 Një punëtori për nxitje të shkëmbimit ndërinstitucional të informacioneve në rastet që kanë të bëjnë me armët e zjarrit, organizuar nga UNODC.
- 13 Fillimi i pastrimit të mbështetur nga UNOPS/UNIDO të ish-fabrikës OHIS (IKOSH) që pritet të përfundojë deri në korrik 2021.
- 14 Promovimi i doracakut të mbështetur nga UNFPA-ja për familjet e fëmijëve me çrregullim të spektrit autik "Të jetosh me autizëm: sfida dhe strategji mbështetëse".
- 14-15 Punëtori e organizuar nga UNDP-ja me përfaqësuesit e nëntë komunave nga rajoni i Pollogut, mbi menaxhimin e zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë.

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Shoqatën Nacionale të Personave Verbërve, e nisi aplikimin e parë natyral të sintezës së të folurit verbal në gjuhën maqedonase. Ky aplikacion, i quajtur Kiko, është falas dhe i lehtë për t'u përdorur për të gjitha moshat, por është zhvilluar kryesisht për të ndihmuar më shumë se 3,000 persona të verbër ose me dëmtim të shikimit në vend, që të mund ta shfrytëzojnë botën e informacioneve duke e përkthyer tekstin digjital në zë në gjuhën e tyre amtare. Aplikacioni është i disponueshëm në pajisjet desktop dhe Android përmes aplikacionit RHVoice Play Store; zgjidhni gjuhën maqedonase pas instalimit.



Aplikimin e parë natyral të sintezës së të folurit verbal në gjuhën maqedonase Kiko

UNDP nisi një thirrje për projekte mbi bashkëpunimin ndër-komunal në kuadër të projektit Kthimi mbrapa i krizës COVID-19: komunat si shtytës të zhvillimit të qëndrueshëm. Në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin Rajonal dhe Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, UNDP po mbështet nisma inovative për krijimin e bashkëpunimit ndër-komunal në tema të ndryshme si menaxhimi financiar, mjedisi, zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe tema të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin lokal dhe rajonal. Për t'i zbutur pasojat e krizës COVID-19, projektet e mbështetura priten të sjellin zgjidhje digjitale për shërbime më të mira komunale më afër qytetarëve, veçanërisht grupeve vulnerable. Zbatimi i projekteve do të krijojë terren për promovimin e praktikave dhe politikave ndërkomunale në Maqedoninë e Veriut. Fondet e projektit (350,000 dollarë) janë siguruar nga UNDP-ja dhe Byroja për Zhvillim Rajonal.

Zbatimi i projekteve do të krijojë terren për promovimin e praktikave dhe politikave ndërkomunale në Maqedoninë e Veriut. Fondet e projektit (350,000 dollarë) janë siguruar nga UNDP-ja dhe Byroja për Zhvillim Rajonal.

Duke u bazuar në arritjet e deritanishme, projekti i UNDP-së për Ndërtimin e Kapaciteteve Komunale për Zbatimin e Projektit do të mbështetet me 471,000 dollarë shtesë nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar. Kjo mbështetje shtesë do të mundësojë zgjerimin e projektit në komuna, qendra rajonale dhe institucione publike të shëndetit për përgatitjen e dokumentacionit të plotë teknik për projektet prioritare të zhvillimit të infrastrukturës. Si pjesë e Fondit të Dokumentacionit Teknik të mbështetur nga projekti, 47 komuna, dy qendra rajonale dhe nëntë spitale do ta marrin dokumentacionin teknik, që është thelbësor për sigurimin e fondeve nga burime të ndryshme qeveritare, donatore dhe burime tjera për investime të rëndësishme. Dokumentacioni teknik është hapi i parë drejt zbatimit të projekteve komplekse të infrastrukturës, që do të rezultojnë me përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së jetës për qytetarët.

UNDP, në bashkëpunim me partnerët nga Ministria e Punëve të Brendshme, e ka përfunduar Fazën e 2-të të zhvillimit të një Sistemi të ri të Menaxhimit të Informacioneve Policore (SMI): Regjistrimi i Incidenteve, Moduli i Dokumenteve dhe Aktiviteteve (RIMDA), si pjesë e projektit Përmirësimi i Vogël Nacional - Praktikave të armëve dhe armëve të lehta dhe ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme. SMI-ja e Policisë

do të jetë e dizajnuar për t'i mbështetur aktivitetet e policisë, ndërkohë që do të sigurojë informacione kyçe, të cilat do t'i ndihmojnë vendimmarrësit t'i identifikojnë dhe luftojnë në mënyrë më efektive shkelësit e shumtë, pikat e nxehta kriminale dhe krimet që përgjithësisht shkaktojnë shqetësim publik.

Projekti UNDP për Fuqizimin e Këshillave Komunale e zgjeroi përdorimin e e-sportelit të tij nga 24 në 36 komuna, me bashkëpunimin e Ministrisë së Financave. Sporteli on-lajn me të dhëna financiare është zhvilluar në vitin 2016 për komunat, që t'i publikojnë të ardhurat, shpenzimet, detyrimet, raportet financiare vjetore dhe tremujore, duke rezultuar në rritjen e transparencës fiskale në nivel lokal, si dhe në përmirësimin e monitorimit qytetar mbi proceset e buxhetimit komunal. Sipas vlerësimit të fundit të shpenzimeve publike dhe logjardhënieve financiare të kryer në komunat partnere, ka pasur përmirësim të ndjeshëm të shpenzimeve publike dhe logjardhënieve financiare të komunave të përfshira në projekt që nga viti 2017, falë Programit gjithëpërfshirës të Zhvillimit të Kapaciteteve të ofruar për më shumë se 250 këshilltarë komunalë.

UNDP, së bashku me përfaqësuesit e nëntë komunave nga rajoni i Pollogut, është duke punuar në pastrimin e shtratit të lumenjve, kanaleve, krijimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm, përgatitjen e planeve operationale të mbrojtjes nga përmbytjet dhe zgjidhjen e zgjuara për qëndrueshmëri urbane. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, një punëtori dy-ditore e projektit të financuar nga Zvicra për projektin e Pollogut të mbrojtur dhe të qëndrueshëm u mbajt më 14-15 korrik, duke arritur në përfundimin se është me rëndësi vendimtare qasja e integruar dhe veprimi i përbashkët për menaxhimin e suksesshëm të rreziqeve të përmbytjeve dhe fatkeqësisve tjera natyrore.

Në fillim të qershorit, **Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)**, në partneritet me USAID-in dhe Finance Think, publikuan një azhurnim të analizës së efekteve sociale dhe ekonomike të COVID-19 te fëmijët, e prezantuar fillimisht në korrik të vitit 2020. Ndohëse masat socio-ekonomike të qeverisë kundër COVID-19 dhe veçanërisht transferimet sociale e kanë zbutur ndikimin në varfërinë të fëmijëve, megjithatë më shumë fëmijë jetojnë nën standardin mesatar të jetesës në vend. COVID-19 parashikohet të ndikojë fuqishëm në varfërinë e fëmijëve: Varfëria relative parashikohet të rritet nga 27.8 për qind para pandemisë në 32.4 për qind pas pandemisë, duke vënë 19,000 fëmijë shtesë nën pragun relativ të varfërisë. Megjithatë, transferimet e rregulluara dhe të zgjeruara të parave të gatshme kontribuan fuqishëm në zvogëlimin e numrit të fëmijëve që jetojnë në varfëri ekstreme, nga 1.5% në 0.6%. Sidoqoftë, është shqetësuese që rreth 27% e familjeve që kanë të drejtë të përfitojnë nga kriteret e lehtësuara për të hyrë në transferimin kryesor social kundër varfërisë (pagesa minimale e garantuar) nuk po e përdorin këtë ndihmë. Për më tepër, ndërprerjet nga shërbimet e mbrojtjes sociale dhe atyre arsimore si dhe ulja e kërkesës për shërbime shëndetësore po i vënë fëmijët në rrezik të mëtejshëm përderisa zgjat pandemia. Një studim i pediatërve tregoi një rënie të vëllimit të punës gjatë COVID-19, kryesisht për shkak të frikës së prindërve dhe fëmijëve nga infektimi me COVID-19 gjatë vizitave të enteve shëndetësore. Analiza e potenciali nevojën për masa të mëtejshme të politikave, përfshirë sigurimin e vazhdimësisë në qasjen e qetë në transferimin e parave kryesore për luftimin e varfërisë: përgatitjen për rihapjen e sigurt të shkollave; rritjen e investimeve në kapacitetet e shkollave për t'u përgjigjur sfidave të shëndetit mendor; zvogëlimin e ndarjes digjitale në arsim veçanërisht për më të prekurit, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara; rivendosijen e plotë të mbrojtjes së fëmijëve - përfshirë shërbimet e parandalimit të dhunës; futjen e masave shtesë për ta rritur besimin dhe kërkesën e publikut për shërbime, përfshirë mbështetjen për shëndetin mendor; përmirësimin e shtrirjes së informacioneve dhe mbështetjen e përfituesve të mundshëm, që të mund të kenë qasje në përfitimet në para.

UNICEF përfundoi një studim të sjelljes mbi jehonën e ulët të marrjes së vaksinës kundër fruthit, shtytave dhe rubeolës (MMR). Afishet e tre prototipeve me informacion dhe pyetje më të shpeshta janë zhvilluar dhe do të shpërndahen në të gjithë vendin në pikat e imunizimit. Aktivitetet do të vlerësohen vitin e ardhshëm për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve në sjelljen kryesore të synuar: marrjen me kohë të vaksinës MMR1, në mënyrë që të shihet nëse intervenime ka qenë me kosto efektive dhe në mbështetje të rritjes së rasteve të vaksinimit.

Si pjesë e Planit të përgjithshëm 2030 para lindjes së foshnjës, të zhvilluar në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe UNFPA-ne, në vitin 2020 UNICEF-i e zhvilloi programin mësimor për trajnim të përshtatshme sipas nivelit përkatës të profesionistëve të kujdesit para lindjes, gjegjësisht për ata të nivelit të lartë dhe të mesëm (obstertikët/gjinekologët/neonatologjistët/mamitë/infermieret). Tridhjetë profesionistë shëndetësorë në repartet neonatologjike të nivelit II u trajnuan në kujdesin para lindjes të bazuar në dëshmitë, parimet e kujdesit adekuat perinatal në raport me rrezikun dhe kriteret e udhëzimit të të porsalindurve dhe nënave.

Takimi i konsultimit me palët përkatëse për ta diskutuar draftin e parë të strategjisë dhe planit të Komunikimit të Rrezikut dhe Angazhimit në Komunitet (KRAK) u organizua nga UNICEF-i më 25 qershor. Konsultimi në fjalë i tuboi Qeverinë dhe partnerët e zhvillimit, praktikuesit dhe shoqërinë civile, si dhe mundësoi të formësohet më tej draft strategjia e KRAK-së. Dokumenti do të ndahet zyrtarisht me homologët e Qeverisë për shqyrtim dhe miratim të mëtejshëm.

Në mbështetje të reformës së vazhdueshme të arsimit fillor, UNICEF-i në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit, ofroi një trajnim të përshtatur për mbi 3,000 mësues mbi metodat dhe teknikat për planifikimin dhe zbatimin e programeve të reja mësimore.

Si pjesë e programit të UNICEF-it për edukimin mjedisor, 32 mësues të shkollave fillore dhe 28 edukatorë të kopshteve iu nënshtruan një trajnimi 10 ditor mbi mësimin eksperimental dhe integrimin e koncepteve mjedisore në mësimdhënie. Ku trajnim u zhvillua midis 28 qershorit dhe 9 korrikut. Qëllimi parësor ishte t'u jepte arsimitarëve shembuj se si shkencë mjedisore dhe klimatike mund të integrohen në mësimet e klasave të hershme të shkollës fillore duke përdorur mësimin eksperimental dhe të bazuar në kërkime. Zonat e përmbytjes që morën fokus të veçantë ishin uji, nxehtësia, atmosfera dhe tokat.

Si pjesë e CINEDAYS, festivali i Filmit Evropian, UNICEF dhe partnerët e kanë mbështetur një program filmik mbi temat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, prodhimin e videoeve të shkurtra dokumentare nga të rinjtë me tema që kanë të bëjnë me ujin, ajrin, mbeturinat, ushqimin dhe ndryshimet klimatike dhe aktivitetet tjera për angazhimin e të rinjve dhe ndërgjegjësimin mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike.



CINEDAYS - program filmik mbi temat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike

Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit të trajnerëve për asistentët arsimorë, një sesion trajnimi me tridhjetë trajnerë u organizua nga UNICEF-i. Fokus i sesioneve të stërvitjes ishte në strategjitë për trajnim dhe lehtësim. Këto

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

sesione afrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për t'i adresuar boshllëqet në njohuri dhe mirëkuptim dhe për të siguruar hapësirë për diskutime dhe reflektime për trajnerët.

Më 14 korrik 2021 u promovua doracak i familjet e fëmijëve me çrregullim të spektrit autik "Të jetosh me autizëm: sfida dhe strategji mbështetëse", me kontributin e **Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA)**-së dhe të mbështetur nga Znj. Elizabeta Gjorgjevska, bashkëshortja e Presidentit të Maqedonisë së Veriut. Evenimenti u organizua nga Instituti për Rehabilitimin e Dëgjimit, të Folurit dhe Zërit - Shkup dhe Klinikës Universitare të Psikiatrisë - Shkup.

Duke u bashkuar me 33 vende të tjera, **Maqedonia e Veriut është vendi i fundit që e miraton Fushatën e Zëmërës Blu të UNODC**-së në përpjekje e saj për ta luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. E shpallur gjatë një sesiioni të Komisionit Nacional për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migrim illegal, Fushata Blue Heart është tani një element qendror i ngritjes së vetëdijes së Maqedonisë së Veriut për t'i dhënë fund këtij krimi dhe për t'i mbrojtur ata që janë në të prekur. Si një nismë globale për ngritjen e vetëdijes për ta luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe ndikimin e saj në shoqëri, Fushata Blue Heart kërkon t'i inkurajojë Qeveritë, shoqërinë civile, sektorin privat, si dhe individët për të vepruar dhe ndihmuar në parandalimin e këtij krimi të urreyer.

UNODC ishte nikoqiri i një Forumi në nivel ministror ku ministrat e Drejtësisë, ministrat e Brendshëm, zëvendësministrat, sekretarët e Shtetit dhe shefat e agjencive për luftë kundër korrupsionit nga gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor e kanë miratuar zyrarisht Udhërrëfyesin Rajonal kundër Korrupsionit dhe Financat Jolligjore për Ballkanin Perëndimor. Fushat kryesore të punës të identifikua janë prokurimet publike; rritja e sistemeve të zbulimit të aseteve, të ardhurave dhe interesave; dhe krijimi i një rrjeti të specializuar të prokurorëve; njëjstëve të zbatimit të ligjit dhe inteligjencës financiare; që do të përqendrohen në tipologjitë kriminale të synuara. Udhërrëfyesi është pjesë e Procesit të Berlinit për Evropën Juglindore (PB).

Programi i Kontrollit të Kontejnerëve të UNODC-WCO (CCP) organizoi një cikël trajnimi teorik për punonjësit e doganës dhe policisë kufitare për të qenë pjesë e grupit ndër-agjencish, që do të krijohet në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit. Trajnimi i ofruar përmes një modaliteti online, trajnimi teorik themelor tre ditor (pjesa 2) siguroi një pasqyrë të teknikave të profilizimit dhe shënjestrimit, zbulimin e kontrabandës së mallrave të paligjshëm, sigurinë e ngarkesave ajrore dhe tema të tjera të trajtuara në trajnimin e mëparshëm. Ky trajnim është realizuar në kuadër të veprimit të përbashkët BE-UNODC për promovimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë përmes masave të synuara të kontrollit të kufirit në porte dhe aeroporte, të financuar nga Bashkimi Evropian.

UNODC e realizoi një punëtori mbi harmonizimin e praktikës gjyqësore në Maqedoninë e Veriut. Dhjetë gjyqtarë dhe kryetarë gjykatash në të gjithë vendin u njohën me "Analizën e vendimeve të UNODC për veprat penale të prodhimit, mbajtjes dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit". Prezantimi dhe shpërndarja e analizës së lëndëve gjyqësore në nivel lokal do të pasohet nga takimet rajonale me qëllim të arritjes së harmonizimit me të madh të praktikës gjyqësore në nivel rajonal dhe nxitjes së shkëmbimit të përvojës mes gjyqtarëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë së Veriut (MYLA) në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe **Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)** e publikuan një Thirrje Publike për Çmim për raportim profesional mbi gjendjen e refugjatëve dhe personave pa shtetësi në Maqedoninë e Veriut për vitin 2020. Këto çmime janë dhënë çdo vit që nga viti 2015.

UNHCR prodhoi video nga aktivitetet që përfshinin refugjatët dhe azilkerkues si pjesë e shënimit të Ditës Botërore të Refugjatëve (20 qershor). Një turne pingpongu dhe një

shëtitje me autobus nëpër Shkup u organizuan së bashku me refugjatët dhe partnerët, duke dhënë mundësinë për të shënuar ditën me popullatën më të prekur.

UNHCR-ja lëshoi një Thirrje Publike për të kërkuar propozime nga ofruesit e shërbimeve të interesuara me ekspertizë përkatëse për inovacionin, parashikimin dhe hartimin strategjik të sektorit publik për këshillim dhe mbështetje të procesit të institucionalizimit të planifikimit dhe zhvillimit të politikave me pjesëmarrje, novatore dhe të ardhshme në institucionet shtetërore dhe të gjithë protagonistëve të shoqërisë në Maqedoninë e Veriut. Angazhimi është pjesë e programit të përbashkët "Planifikimi dhe diskursi i politikës së migracionit të bazuar në dëshmi", program i përbashkët (PP) i financuar nga Fondi i mirëbesimit i OKB-së për migracion me shumë partnerë, i cili synon t'i mbështesë institucionet nacionale në zhvillimin e qeverisjes së mirë të migrimit në Maqedoninë e Veriut përmes përforcimit të bazuar në dëshmi, diskursin dhe zhvillimin e politikave të migrimit të dirigjuara nga të dhënat dhe inovacionet. PP zbatohet nga **Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)**, UNFPA dhe UNHCR-ja.

Rëndësia e të dhënave cilësore, të qasshme, të ndara, të besueshme dhe të disponueshme në kohë për t'i informuar politikant, veprimet dhe opinionin publik mbi migrimin është e njohur mirë dhe e theksuar në korniza të shumta ndërkombëtare, duke përfshirë Kompaktin Global për Migrim të Sigurt dhe të Rregullt. Si palë kyçe e të dhënave kryesore në të drejtën e vet dhe si koordinator dhe sekretariat i Rrjetit të Kombeve të Bashkuara për Migracionin, IOM-i ka një pozicion unik për të ndihmuar në përbushjen e këtyre qëllimeve në lidhje me të dhënat mbi lëvizjen e njerëzve. Si pjesë e PP-së, IOM-i i ka mbështetur autoritetet në Maqedoninë e Veriut në fuqizimin e sistemeve për mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare dhe të besueshme të migracionit. Gjatë gjithë vitit 2021, Udhërrëfyesi Nacional për Statistikat e Migracionit është zhvilluar së bashku me Entin Shtetëror të Statistikës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Udhërrëfyesi është një dokument strategjik udhëzues që paraqet një pasqyrë të sistemeve dhe praktikave aktuale mbi statistikën e migrimit në vend, duke përfshirë nevojat dhe sfidat, dhe siguron një afat kohor të orientuar drejt zgjidhjes dhe harmonizimit të plotë me standardet e BE-së mbi statistikën e migracionit.

Më 23 qershor, IOM-i e organizoi punëtorinë e fundit nga vargu i gjerë i punëtorive, që synonin finalizimin e Udhërrëfyesit, i cili pritet të vërtetohet dhe miratohet nga autoritetet nacionale deri në shtator të vitit 2021, pas së cilës IOM do të ofrojë mbështetje në funksionimin e rekomandimeve dhe zgjidhjeve të ofruara në dokument. Me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe në kontekstin e proceseve të pranimit në BE, IOM-i është i përfshirë në aktivitetet të ngjashme mbështetëse gjithëpërfshirëse për statistikën e migrimit në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e njohurive u organizuan në kuadër të projektit të **UN Women** "Promovimi i politikave dhe buxheteve me përgjegjësi gjinore: Drejt një qeverisjeje transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut", të financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim si dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar:

- Së bashku me Komisionin Parlamentar për Mundësitë e Barabarta, Klubin e Grave Deputete, Komisionin për Financa dhe Buxhet dhe Institutin Parlamentar, UN Women ndihmuar një takim tematik mbi vlerësimin gjinor të politikave dhe ligjeve, gjegjësisht rolin e Parlamentit si një mekanizëm mbikëqyrës.

- Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) organizoi një Forum për shkëmbimin e praktikave komunale mbi integrimin gjinor dhe zbatimin e buxhetit të ndjeshëm gjinor në nivel lokal, duke mbledhur kryetarë komunash dhe zyrtarë komunalë në të gjithë vendin.

- Komunitet partnerë të OKB-së shkëmbyen ide novatore dhe praktika lokale për të investuar në shërbime sociale të qëndrueshme dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë gjatë një punëtorie 2-ditore të organizuar si pjesë e programit të vazhdueshëm të trajnimit dhe mentorimit mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

- Enti Shtetëror i Revizionit dhe UN Women po e vazhdojnë bashkëpunimin në forcimin e kapaciteteve të Entit Shtetëror të Revizionit për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. 34 auditorë nga EShR fituan njohuri mbi integrimin e perspektivës gjinore në proceset e auditimit dhe vlerësimin e ndikimit gjinor të politikave dhe rregulloreve.

- Kryetarët e komunave dhe kryetarët e këshillave komunalë nga Maqedonia e Veriut patën mundësinë të mësojnë për punën mbresëlënëse të berë nga Komuna e Tivarit, Mali i Zi për mbështetjen e sipërmarrjes së grave dhe fuqizimin ekonomik gjatë një vizite studimore të organizuar nga BNJVL-ja.

- Akcja Zdruzenska, me mbështetjen e UN Women në kuadër të projektit për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, organizoi një punëtori tre-ditore të rrjetëzimit për përfaqësuesit e nëntë organizatave bazë dhe grave nga 20 komunitete rurale.

Zyra e UN Women për Maqedoninë e Veriut mori pjesë në nismën rajonale "Artvizimi Mural: Thyerja e mureve të pabarazisë gjinore" - <https://bit.ly/3AVXl0c>

Zyra e UN Women i mbështeti përpjekjet e komunikimit gjatë fjalimit të Presidentit të Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, në Forumin e Parisit mbi Barazinë e Gjeneratave. Presidenti i kumtoi zotimet nacionale si udhëheqës të vendit në Koalicionin e veprimit për autonominë trupore dhe të drejtat seksuale dhe shëndetin riprodhues.

MYLA, organizatë partnere e UN Women në kuadër të Programit Rajonal EVAW për Implementim të Normave për Ndërrim të Botëkuptimeve, e organizoi një ngjarje përmbyllëse për projektin e tyre "Krijimi i një Kulture drejt Barazisë Gjinore" ku 240 nxënës dhe 18 punonjës të shkollave të mesme u fuqizuan të punojnë si avokatë kundër stereotipeve të dëmshme gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Tre grupe lokale shumë sektoriale për të mbijetuarit e dhunës u krijuan në Strumicë, Shtip dhe Veles për të siguruar bashkëpunim të rregullt dhe cilësi të shërbimeve, të ofruara për të mbijetuarat e dhunës kundër grave. Ky proces u mbështet nga HERA, një organizatë partnere e UN Women në kuadër të Programit Rajonal EVAW Implementim të Normave për Ndërrim të Botëkuptimeve.

UN Women dhe partnerët tjerë të OKB -së e mbështetën organizimin e panelit me temën "Gratë, Paqja dhe siguria - një këndvështrim nga Ballkani Perëndimor", si pjesë e Forumit të Dialogut të Prespës, i cili përfshinte znj. Radmilla Shekerinska, ministre e Mbrojtjes dhe z. Miroslav Jenča, ndihmës sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për Evropën, Azinë Qendrore dhe Amerikën, si dhe personalitete të tjera nga rajoni. Ata diskutuan se si të sigurohet barazia gjinore, drejtësia dhe barazia përmes avancimit të agjencisë së grave në paqë dhe siguri në Ballkanin Perëndimor, gjegjësisht përparimin e grave në të gjitha sferat e sektorit të sigurisë.

UN Women morën pjesë në takimin e parë rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor, për ta diskutuar mbështetjen e dhënë qeverive nacionale në lidhje me lehtësinë e barazisë gjinore dhe Instrumentin për Asistencën Paraadheruese (IPA), si dhe hapat e ardhshëm.

Edhe zyrtarisht kanë filluar punimet në terren për sanimin e mbetjeve të lindanit nga vendgrumbullimi i vogël në ish-fabrikën OHIS (IKOSH). Operacioni kompleks i pastrimit është një veprimtari e koordinuar e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO), të cilët i bashkuan forcat për t'i koordinuar operacionet në terren që do të kryhet në përpulje me standardet nacionale dhe ato ndërkombëtare. Në këtë partneritet, UNOPS-i e menaxhon Fondin mjedisor më shumë partner, të krijuar me qëllim të mobilizimit të burimeve nacionale dhe ndërkombëtare për ta mbështetur pastrimin e këtij vendi dhe për ta lehtësuar koordinimin e donatorëve. Aktivitetet e pastrimit pritet të përfundojnë deri në korrik të vitit 2022.



UNOPS organizoi një trajnim teorik dhe praktik për stafin e zyrës së Avokatit të Popullit mbi parimet dhe teknikat e drejtimit të hetimeve dhe kryerjes së kontrollimeve efektive. Trajnimi u përqendrua në mekanizmat për mbrojtjen e së drejtës për jetë dhe liri nga tortura, nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

OBSh për Maqedoninë e Veriut mblodhi mbi 80 përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, USAID-it, Bankës Botërore, agjencive të OKB-së, ambasadave, shoqatave të mjekëve, organizatave joqeveritare dhe partnerëve tjerë nga një spektër i gjerë sektorësh për t'i prezantuar dhe diskutuar gjetjet nga "studimi cilësor i punonjësve të kujdesit shëndetësor për vaksinimin kundër COVID-19 në Maqedoninë e Veriut" dhe "Raundi i fundit i studimit të sjelljes gjatë COVID-19 në Maqedoninë e Veriut". Kuptimi i perspektivave të punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe publikut të gjerë mbi vaksinimin kundër COVID-19 është çelësi kryesor i politikëbërjes efektive për përballje me pandeminë.

OBSh-ja dhe UNICEF-i në Maqedoninë e Veriut janë duke e zbatuar së bashku fushatën e komunikimit të rrezikut të përgjegjshmërisë gjatë verës. Kjo bëhet me qëllim të zvogëlimin të rreziqeve nga infektimi i njerëzve me COVID-19 gjatë verës dhe për ta shmangur përhapjen e infeksionit. Fushata në fjalë është e fokusuar në pesë fusha: udhëtime dhe turizëm, ngjarje sportive, jetë në ambiente të hapura (tubime shoqërore, festivale, dasma, pushime në plazh), sjelljet e njerëzve të vaksinuar dhe shkollave, universiteteve.

Me ekspertizën teknike nga Qendra Ballkanike e OBSh-së, OBSh-ja organizoi një punëtori konsultative dy-ditore për 32 pjesëmarrës nga Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë, Qendrat rajonale të Shëndetit Publik, drejtoria e Shëndetit, Instituti i Epidemiologjisë dhe të tjerë, me qëllim të rritjes së funksionalitetit të Qendrës së Operacioneve Emergjente të Shëndetit Publik dhe rrjetit të shëndetit publik. Një Qendër e tillë funksionale luan rol jetik në koordinimin e partnerëve që reagojnë ndaj kërcënimeve dhe emergjencave të shëndetit publik.

Në fokus Mali Sharr

Me rreth 6,000 lloje të ndryshme të florës dhe faunës të identifikuar deri më tani, nga të cilat 220 janë endemike, shumë liqene akullnajorë dhe rreth 40 maja mbi 2.500 metra, Mali Sharr e ka tërhequr me të drejtë interesin e shkencëtarëve, shëtitësve, dashamirëve të natyrës, adhuruesve të sporteve dimërore dhe të tjerëve për një kohë shumë të gjatë. Ai siguron strehim për rrëqebullin Ballkanik të rrezikuar në mënyrë kritike (nga të cilët kanë ngel rreth 35). Sharrin strehon rreth 20,000 njerëz të etnive të ndryshme të vendosur në 30 fshatra dhe burime që e sigurojnë jetesën e shumë të tjerëve.

Sidoqoftë, shfrytëzimi intensiv dhe i pakontrolluar i malit çoi në trazimin, madje shkatërrimin e habitateve. Prerjet ilegale dhe ndërtesa e pamatur e pllakosën vargmalin, duke rezultuar në një frekuencë të shtuar të përmytjeve të shpejta. Si rezultat i kësaj, dashamirët e natyrës, njerëzit vendas, ekspertët dhe institucionet e ndryshme të lidhura me natyrën zhvilluan betejë gjatë disa dekadave për ta mbrojtur ligjërisht Malin si një park nacional, gjë që u miratua nga parlamenti i Maqedonisë së Veriut më 1 korrik të vitit 2021.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) e ka mbështetur ruajtjen e natyrës në Maqedoninë e Veriut përmes projekteve të ndryshme gjatë 15 viteve të fundit. Gjatë kësaj kohe, UNEP e njohu rëndësinë e iniciativës për mbrojtjen e Malit Sharr dhe mori pjesë aktive në këtë proces. Gjatë pesë viteve të fundit, UNEP-i ka zbatuar një projekt të financuar nga Mekanizmi Global i Mjedisit, i cili synon arritjen e ruajtjes së shtuar të biodiversitetit. Ky projekt kontribuon në përbushjen e qëllimeve të kornizës globale të biodiversitetit të vendit pas vitit 2020 nën ombrellën e Konventës për Diversitetin Biologjik. Po ashtu projekti kontribuon në përbushjen e detyrimeve nacionale që burojnë nga nënshkrimi i Deklaratës së Sofjes - e ashtuquajtura Agjenda e Gjelbër e BE-së për Ballkanin Perëndimor. Megjithatë kontributi më i rëndësishëm është ai që iu bëhet njerëzve dhe natyrës në Maqedoninë e Veriut. Një nga rezultatet e projektit është shpallja e Malit të Sharrit si park nacional.


Procesi: hap pas hapi

Procesi i shpalljes së Malit Sharr si park nacional kërkoi hulumtime të gjera si për vlerat natyrore ashtu edhe ato socio-ekonomike të Malit. Këto u përkthyen në dy studime gjithëpërfshirëse. Studim socio-ekonomik, zhvillimi i të cilit u mbështet financiarisht nga Ministria italiane e Mjedisit, Tokës dhe Detit dhe që veprimi i një dokument shtesë, ishte përdorur për t'i plotësuar aspektet përkatëse të studimit kryesor të vlerësimit - dokument zyrtar që e formon bazën e procesit të shpalljes si park nacional. Rreth 70 ekspertë nacional punuan në zhvillimin e studimit, i cili u paraqiti së bashku me nismën për ta shpallur Malin Sharr si park nacional në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Pas dorëzimit të nismës dhe studimit, MMJPH e shpiu procesin më tej, duke i paraqitur një nismë Qeverisë dhe të gjitha institucioneve përkatëse për shpalljen e Malit Sharr si Park Nacional. Në maj të vitit 2020, Qeveria e pranoi nismën dhe kërkoi që ajo të harmonizohej me pikëpamjet e të gjitha institucioneve. Një proces negociues që u ndoq me të gjitha palët e interesuara, ku MMJPH dhe UNEP, së bashku me disa ekspertë kryesorë, i diskutuan të gjitha shqetësimet me palët e interesuara. Pas debatit zyrtar publik, propozimi u rregullua sipas komenteve të marra. Një fushatë publike u zhvillua në dy faza, në mënyrë që njerëzit të ishin të vetëdijshëm për ndryshimet dhe hapat e ardhshëm. Përfundimisht, vendimi për shpalljen e Sharrit për Parku Nacional u mor nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut.

Çfarë dallime do të sjell Parku Nacional?

Krijimi i Parkut Nacional Mali Sharr në Maqedoninë e Veriut do të thotë se tani është vendosur në vendin e duhur pjesa e fundit e rebusit për një nga zonat më të mëdha të mbrojtura ndërkufitare

në Evropë. Me miratimin e parkut të ri nacional 627 kilometra katrorë, është krijuar një zonë e mbrojtur ndërkufitare që arrin gjithsej rreth 2,400 kilometra katrorë.



Përmes këtij vendimi, përveç krijimit të mundësisë për mbrojtje dhe ruajtje të biodiversitetit dhe të gjitha vlerave natyrore, është bërë një angazhim për t'i përdorur burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Po ashtu po hapen mundësi të reja për të zhvilluar forma alternative të turizmit dhe për promovim të rajonit.

Sidoqoftë, vetë shpallja si e tillë, nuk është e mjaftueshme për ta siguruar ruajtjen e natyrës dhe prosperitetin e qëndrueshëm socio-ekonomik. Që parku të menaxhohet ashtu siç duhet, ka nevojë për planifikim adekuat. Në këtë drejtim, dhe brenda fushëveprimit të të njëjtit projekt (Mekanizmi Global i Mjedisit), veç më është duke u përgatitur propozimi i planit të menaxhimit. Gjatë zhvillimit të tij, UNEP-i, MMJPH-ja dhe ekipi i ekspertëve i udhëhequr nga Unioni nacional për Ruajtjen e Natyrës po e diskutojnë me palët e interesuara menaxhimin e ardhshëm të burimeve natyrore dhe të të gjitha aktivitetet ekonomike brenda parkut. Plani i menaxhimit duhet të japë një pamje të përgjithshme e asaj që lejohet dhe ndalohet në zona të ndryshme të Parkut. Sidoqoftë, organi i sapo formuar i Parkut do të ketë nevojë për mbështetje shtesë në të gjitha aspektet e qeverisjes së territorit. Vendasit që jetojnë në park gjithashtu do të kenë nevojë për udhëzime në mënyrë që t'i shfrytëzojnë mundësitë që ofron zona e mbrojtur. UNEP-i aktualisht kërkon të sigurojë fonde për projekte të tjera që do ta mbështesin trupin menaxhues dhe do ta ndihmojnë zhvillimin e njerëzve dhe komuniteteve lokale.

Shpallja e parkut nacional është një hap i madh për Maqedoninë e Veriut, pasi parku i fundit nacional në vend është formuar më shumë se 60 vjet më parë. Kjo është një arritje që duhet duartkruar dhe kremtuar nga të gjitha palët e përfshira. Mirëpo është gjithashtu një detyrim i menjëhershëm për t'i fuqizuar më tej përpjekjet për t'i mbrojtur dhe ruajtur pasuritë natyrore të Malit të Sharrit, për florën, faunën dhe për të gjithë njerëzit që janë disi të lidhur me pasurinë e tij natyrore.

Links:

<https://www.unep.org/news-and-stories/press-release/missing-piece-puzzle-sharr-mountain-national-park-approved>

<https://www.euronatur.org/en/what-we-do/endangered-species/lynx/lynxes-in-europe/projects/balkan-lynx/>

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 10 June 2021

www.un.mk